

erzioni angleze me mbijotru  
Енглеска верзија савладати  
English version prevails

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO

MEMORENDUM ZYRTAR

СЛУЖБЕНИ МЕМОРЕНДУМ

Për / За / To	Të gjithë Deputetët e Kuvendit Све Посланике у Скупштини All Members of the Assembly	DATA ДАТУМ DATE	25. Qërrshor 2002 25. Јуна 2002.година 25 June 2002
NGA / OD / FROM	Franck Boulin Ushtrues i detyrës së Sekretarit të Kuvendit / Вршичаш дужности Секретара Скупштине / Acting Secretary to the Assembly		
SUBJEKT ПРЕДМЕТ SUBJECT	Mbledhja e Kuvendit / Заседање Скупштине / Meeting of the Assembly		

Mbledhja e ardhshme e Kuvendit do të mbahet:

Të enjten më 27 Qërrshor 2002 në orën 10.00:  
Në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës

Ftohën të gjithë Deputetët e Kuvendit të marrin pjesë

Rendi i ditës është i bashkëngjitur.

Следећа седница че бити одржана

Четвртак 27 Јуна 2002 у 10.00 часова  
У Скупштинској Сали у згради Скупштине Косова

Сви Посланици се позивају да учествују.

Дневни ред је у прилогу

The next meeting of the Assembly will take place on:

Thursday 27 June 2002 at 10.00 am  
In the Assembly Hall of the Assembly Building, Pristina

All members of the Assembly are invited to attend.

The agenda for the meeting is attached.

Verzioni angleze me mbizotru  
Енглеска верзија савладати  
English version prevails

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Hapja e mbledhjes
2. Rekomandimi i Këshillit të Gjykatësve dhe Prokurorëve mbi emërimin e Gjykatësve dhe Prokurorëve
3. Prezentimi dhe leximi i parë i projektligjit Nr. 2002/1 mbi *Metodologjin e përcaktimit të nivelit të pensionit themelor në Kosovë dhe caktimi i datës për fillimin e pagesës së pensionit themelor*
4. Propozim për krijuimin e dy komisioneve të Kuvendit
  - Komisioni për të zhdukur
  - Komisioni pë barazi gjinore
5. Datat për pushim veror
6. Të ndryshme
7. Përfundimi i mbledhjes

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Отварање седнице
2. Препоруке Савета Судија и Тужилаца о именовању Судија и Тужилаца
3. Представљање и читање нацрта закона бр.2002/1 о *Методологију за одређивање нивоа основне пензије на Косову и одређивање датума за почетак исплате основних пензија*
4. Предлог за оснивање два комитета Скупштине
  - Комитет за несталих лица
  - Комитет за равноправност полова
5. Термини за лjetни одмор
6. Разно
7. Завршетак седнице

Verzioni angleze me mbizotru  
Енглеска верзија савладати  
English version prevails

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**AGENDA**

1. Opening of meeting
2. Recommendation of the Kosovo Judicial and Prosecutorial Council (KJPC) for the appointment of judges and prosecutors
3. Presentation and First Reading of Draft Law No. 2002/1 *on the Methodology for Setting the Level of Basic Pension in Kosovo and Determining the Commencement Date for Provision of Basic Pension*
4. Proposal for further committees of the Assembly
  - Committee on missing persons
  - Committee on gender equality
5. Dates for summer recess
6. Any other business
7. Close of meeting

## **SEANCA E KUVENDIT TË KOSOVËS, MBAJTUR MË 27.6.2002**

### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI,**

Më lejoni të hapë mbledhjen plenare të Kuvendit të Kosovës dhe me kënaqësi të veçantë të përshëndes praninë kryeministrat të Qeverisë së Kosovës Dr.Bajram Rexhepin dhe kryeministrat që e shoqërojnë Jakup Krasniqi dhe Z. Ahmet Isufi. Do t'ju pyesja . Besoj që rendin e ditës e keni marrë të gjithë. A pajtoheni me rendin e ditës? Kush është për, Urdhëroni.

### **RANDJEL NOJKIĆ**

Mi predlažemo da se treća tačka povuće sa dnevnog reda zato što nam je predsednik Komisije resorne Komisije, koja raspravlja ova pitanja, i rekao da komisiji nisu dostavljena sva dokumenta kako bi moglo da se taj Zakon u potpunosti na komisiji razmotri i smatramo da ne možemo relevantno da raspravljamo u ovim Zakonu danas. Te primedbe koje su date na Komisiji i dokumenta koje su tražena nisu dostavljene ni sada poslanicima, hvala

### **MUHAMET KELMENDI UNIKOMB**

Zonja dhe zotërinjë, zoti kryetar,

Në qoftëse më lejohet, i kisha marrë disa minuta për rendin e ditës.Kam menduar të propozoj që të shtohen edhe disa çështje tjera të rendit të punës, për të cilat na obligon situata aktuale në Kosovë, na obligon gjendja të cilën jemi duke kaluar dhe problemet me të cilat po ballafaqohet shoqëria kosovare. Përveç pikave të rendit të punës, të cilat unë i përkrahi në tërësi, mendoj që për sot, duke u mbështetur në situatën aktuale të cilën po kalon Kosova, pra përveç që e përkrahi rendin e punës të propozuar nga Kryesia, mendoj se për sot duke u mbështetur në situatën aktuale në gjendjen që është krijuar në Kosovë ka qenë e preferueshme që t'i shtojmë edhe disa pika të rendit të punës dhe të vazhdojmë me punë, pastaj në qoftëse ka nevojë, jo vetëm sot por edhe nesër edhe pas nesër siç është traditë e punës së kuvendeve çdo kund në botë. Ju e dini në seancën e punës të Kuvendit të Kosovës përveç që e murëm një projektregullore për themelimin e Agjensisë të mirëbesimit të Kosovës, dikund 5 minuta para se të fillojë seanca ne ja filluam diskutimit, pa e ditur fare, pa e lexuar askush prej nesh, dhe të njejtën kohë deri sa

ky Kuvend ishte duke diskutuar dhe e nxorr vendimin më në fund përfaqësuesi special i sekretarit të Përgjithshëm z. Shtajner e thirr një mbledhje dhe në praninë e mediave të shkruara dhe elektronike, ende duke i vazhduan punimet, ky Kuvend, e nënshkroi projektregulloren e tillë dhe e bëri të plotfuqishme. Unë mendoj që sekretari i atij Kuvendi këtu ka bërë një shkelje jashtëzakonisht të rëndë dhe mendoj se është dashur që sot të kem në rendin e punës. Një pse vihet 5 minuta para se të filloj seanca, 2 Pse të diskutohet dhe 3 Pse gjatë diskutimit nënshkruhet rregullorja e tillë ende pa i përfunduar punimet kjo seancë, gjë që mendoj se është ofendim i Kuvendit, ofendim i votës të gjyqëtarëve të Kosovës, dhe i vetë deputetëve çdo njëri nga ne veç e veç. Çështja e dytë për të cilën mendoj që duhet është çështja se ky Kuvend jo vetë që duhet të nxjerrë mendime, çëndrime dhe rezoluta por ka për obligim të punojë në drejtim të zbatimit të tyre në praktikë, ne kemi nxjerrë një rezolutë, është anuluar pas disa minutave dhe nuk e dimë fatin e saj. Mendoj se poashtu është dashur se në seancat tjera të kaluar jo sot më herët ose në të ardhmen në seancë të veçantë të diskutojmë këtë çështje dhe të shofim se kush ka të drejtë, a qytetarët e Kosovës të cilët me votën e vetë e kanë zgjedhur këtë Kuvend, të diskutojë për problemet që kanë apo përfaqësues special i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili në mënyrë arbitrale e anulon një vendim e organeve më legitime dhe më demokratike të Kosovës. Ne të gjithë jemi dëshmitarë se mbrenda kësaj periudhe trivjeçare në Kosovë kanë ndodhur burgosjet e herëpas hershme, janë burgosur ish ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të TMK-së dhe kështu me rradhë dhe kanë shkuar nëpër gjykata procedura dhe në fund gjykata i ka lëshuar si të pafajshëm. Çdoherë janë burgosur në bazë të akteve administrative një rregull që askundë në botë nuk ekzistonë dhe aq më keq ne të gjithë jemi dëshmitarë të një deklarate të zëvendësit të ose policisë UNMIK-ut i cili thotë i burgosëm shqiptarët të cilët kanë vrarë shqiptarët pas luftës, pas përfundimit të luftës. Për mendimin tim, ky është ofendim që i bëhet qytetarëve të Kosovës se në Kosovë të gjithë qytetarët janë të barabartë dhe në fund të fundit zero toleranca duhet të jetë për të gjithë. Me të drejtë shtohet pyetja se kush është përgjegjës për 15 mijë të mbytur në Kosovë, sa veta i kemi nëpër burgje. Kush është përgjegjës për shkatërimin e tërësishëm që ju ka bërë Kosovës dhe sa veta gjinden nëpër burgje. Unë nuk dua që t'i pëzihem organeve të judikaturës se është e drejtë dhe detyrë e tyre për ta analizuar këtë çështje. Po mendoj se edhe ne kemi të drejtë se aq ma tepër kur

këto probleme janë të shoqërisë sonë nëpër të cilin kemi kaluar e meremi me këtë çështje, Prandaj, mendoj se këto tri çështje të cilat i kemi theksuar është dashur që ne ti quesim nëpër seanca të veqanta. Është dashur ose sot në vazhdimësi tre vjetori në qoftëse është nevoja t'i diskutojmë këto probleme, sepse janë probleme madhore me të cilat po ballafaqohet shoqëria jonë. Unë vij nga Peja. Ju të gjithë e dini se qytetarët e Pejës qe tri ditë dalin në protesta, me të drejtë sepse po ata njerëz janë që kanë udhëhequr atë pjesë të Pejës për çlirim e atij vendi, dhe natyrisht unë nuk du ta përkrahi dhunën dhe terorin. Askush nga ne, askush nga qytetarët dhe mendoj se është e drejtë ligjore dhe e drejtë e domosdoshme e këtij Kuvendi që të mirret me këtë çështje dhe jo t'i lëmë që situata të eskalojnë nga duartë t'i marrim njerëzit nëpër burgje me vendime të ndryshme administrative dhe ti obligojmë gjykatës rrugën se ku do të ecë, ju falemnderit,

### **HAJREDIN KUQI PDK**

I nderuar kryetar i nderuari kryeministër, zonja dhe zotërinjë,  
Unë me të drejtë pata kërkuar nga kryeministri herën e kaluar që të ofroj një raport për vizitën e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Qëllimi ishte që të krijohet një praktikë në Kuvendin e Kosovës që të raportohet për vizitat zyrtare para këtij organi të gjithë ata të cilët janë përgjegjës.

Një gjë të tillë e kërkoj sot edhe nga delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i cili ishte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në veçanti dëshiroj që sot Kuvendi ynë të diskutoj nëse nuk është i përregatitur në mbledhjen e ardhshme për atë vizitë dhe deklarimet, të cilat kanë qenë në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe në kundërshtim me politikën e Kuvendit të Kosovës. Në një mbledhje të afërt të Kuvendit do të propozoj sot por edhe me shkrim do t'i propozojë Kuvendit të Kosovës që t'i kemi parasysh dhe t'i diskutojmë një ditë për lëshimet e tepruara jo demokratike që janë bërë në raport sidomos me disa persona që kanë qenë peng të politikës deskriminuese shqiptare për 10 vjet.

### **BERAT LUZHA PDK**

Për mua vazhdimisht rendi i ditës në Kuvend është i përcudshëm, abstrakt i pakuptueshëm. Rekomandimi i këshillit gjykatësve dhe prokurorëve unë nuk e di së pari

rekomandim duhet të jetë i Këshillit gjykatësve të Kuvendit apo rekomandim që duhet t'ju ipet këshilli i gjykatësve. A kemi të drejtë të japim rekomandim apo duhet të miratojmë vendimin apo kriteret e këshillit të gjykatësve apo emrimin e gjykatësve dhe prokurorve.

Ne pikën 3 thotë , prezentimi dhe leximi i parë i projektligjit, faktikisht ne duhet të mendojmë për miratimin e projektligjit jo për prezentim dhe lexim të parë. Nëse ka lexim të parë do të ketë edhe lexim të dytë të tretë e kështu me radhë. Prandaj duhet të sqarohet dhe të precizohet edhe ky term, dhe të thuhet, diskutimi dhe miratimi i projektligjit 2002 /1, dhe në pikën 4 kam vërejtje se në formimin e komisioneve, komisioni për të zhdukur do të jetë një komision a dëhok i cili do të punojë deri në zgjidhje përfundimtare të këtij problemit deri në evidencimin e të gjithë atyre të cilët konsiderohen si të zhdukur kurse komisioni për barazi gjinore fare nuk ka të formohet, e në vend të këtij komisioni të formohet për media,i cili është kërkuar vazhdimisht dhe nuk është përfillur. Ju falemdnerit.

### **OLIVER IVANOVIĆ KP**

Ja bih krenuo sa jednom primedbom, to je da nikakva uvodna izlaganja ni od kog poslanika, po meni pod dnevni red nisu predviđena, tako da izlaganje g. Kelmendi mislim neprimernim. Predpostavljam da bi Predsednik u ovakvoj situaciji da mu uzme reč, molim vas da uz to uzdržite se, jer kad god poslanici koalicije Povratak vi ste vrlo strikti pod tom pitanju, ja se nadam da vi prema svima budete ravnopravni. Vezano za dnevni red, predlažem da se dnevni red izmeni i da se ubaci tačka od predhodne sednice, jer je to praksa. Mi u prilogu imamo zapisnik i na taj zapisnik imamo određene primedbe, a ako se u tome striktno držite ovog dnevnog reda, mi o tome ne bismo da razgovaramo. Predlažem samo da se oko ove tačke, tačke tri, kažem razmotrite mogučnost, neću insistirati na tome da se ova tačka skine sa dnevnog reda jer nemamo izveštaj službe, izveštaj odbora za koji je trebao da mišljenje, po tom, ovo pitanje Predlog zakona o određivanje nivoa penzija. Što se tiče tačke dva ja sam i na Predsedništvo imao ozbiljnih primedbi na način kako se utvrđuje lista sudijsko koju mi danas treba da razmotrimo, razmišljao sam da vrlo štura dokumentacija koje došla uz kandidate i mislio sam da ove relevantne organizacije koje se bave pračenjem rada suda

obzirom da su neki od kandidata koje se nalaze na listi i ranije se bavili pravosudnom funkcijem i da su u njihovom radu ima punih grešaka i puno propusta koji ne proporučuju u budućim sudovima. Da rezimiram, da ubaci tačku usvajanja zapisnika sa predhodne sednice, da se tačka dva skine, jer ona nije dovolja pripremljena i tačku 32 dopunsko mišljenje oko ovog zakona koji je bio predviđene za čitanje za danas. U zapisniku stoji, ono što mi stavljamo primendbe jeste da prvo mi nismo srbski minoritet i mi nismo glasali i mi smo napustili sednicu kao koalicija Povratak, to je vrlo važno, za nas, ne znam koliko je važno, za vas i mislim da nije netačno interpretiram

Stav izjava g. Trajković kao šefa poslaničke grupe. Hvala vam.

### **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit prej të gjithëve, rendin e ditës njëzërit e ka propozuar Kryesia e Kuvendit. Pjesa më e madhe e sygjerimeve të z. Kelmendi është plotësisht në rregull dhe Kryesia e ka pasur të njejtën sygjerim dhe vërejtje se nuk është në rregull deri sa është në sesion Parlamenti i Kosovës, derisa dikush tjetër me nënverësim t'i ndërmerrë hapat të tilla dhe do të mundohemi në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në UNMIK të eliminohen të gjitha këto si edhe vërejtja e z. Kuçi, por mendoj që njëherë duhet të shkojë në Kryesi raporti, pastaj t'i rekomandohet Kuvendit. Rendi i ditës njëzërit është aprovuar në Kryesi. Ju lutem, kush është për votim, ju falemnderit. Kush është kundër, 7 kundër, abstenon dikush, ju lutem vazhdojmë me rendin e ditës,

Rekomandimi i këshillit të gjykatësve të prokurorëve për emrimin e gjykatësve dhe prokurorëve.

Lus z. Fatmir Sejdiu që të lexojë raportin e Kryesisë së Kuvendit.

### **FATMIR SEJDIU,**

Zoti Kryetar, Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2002, përveç tjerash, shqyrtoi raportin e komisionit të Kuvendit të Kosovës për çështje juridike - legislative dhe Kornizë Kushtetuse lidhur me propozimet e bëra nga ana e Këshillit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës për emërimin e gjyqëtarëve në gjykatat komunale dhe gjykatat e qarkut në Kosovë.

Duke pasur parasysh listën e të propozuarëve nga ana e komisioneve të Kvuendit, Kryesia e Kuvendit mbështeti propozimin e kandidatëve të nominuar dhe ia paraqet Kuvendit për miratim, duke pasur parasysh kompetencën e tij të përcaktuar me nenin 9.4.8 të Kornizës Kushtetuese për vetqerverisje e përkohëshme në Kosovë.

Propozimi është si vijon; për gjyqëtarin në Gjykatën Komunale në Prishtinë të zgjedhen: Flutra Hoxha, Hamdi Ibrahim, Hajrije Shala, Alltën Murseli,

Për gjyqëtarë në Gjykatën e qarkut në Gjilan; Tomislav Jovanoviq,

Për prokuror në Gjykatën komunale në Gjilan Jetish Maloku, Afrim Shefkiu,

Për gjyqëtarë në Gjykatën komunale në Viti Ibrahim Idrizi, Sylejman Sallahu,

Për gjyqëtarë në Gjykatën për kundravajtje në Viti; Gjavit Haziri,

Për gjyqëtarë në Gjykatën komunale në Dragash, Ajser Beshi,

Për gjyqëtar në Gjykatën e qarkut në Mitrovicë, Emine Kaçiku, Emine Mustafa, dhe Enver Pesi, ky është propozim.

Kryetari i Komisionit dëshiron ta ketë fjalën,

## **ARSIM BAJRAMI PDK**

Fillimisht dua ta sqaroj se si shkon procedura për zgjedhjen e gjyqëtarëve, meqenëse pas miratimit të Kornizës Kushtetuese është aplikuar një mekanizëm i ri për zgjedhjen e gjyqtarëve. Kjo procedurë kalon në 4 faza. Faza e parë është, propozimet që vijë nga komisioni prokural që ka statusin e komisionit të pavarur që emërohet nga përfaqësuesi special. Faza e dytë, ajo të cilën tani jemi, pra, propozimi i komisionit adekvat funksional të Kuvendit të Kosovës në këtë rast komisionit për çështjet gjyqësore legislative dhe kushtetuese. Ky komision del me propozim para Kuvendit. Kuvendi me një votë formale aprovon listën e kandidatëve të propozuarëve e më pastaj i dërgohet përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm për miratim apo për zgjedhje.

Me rastin e propozimit për Kuvendit sot kemi komisionin për çështje gjyqësore dhe legislative ka mbajtur dy mbledhje dhe ne kemi caktuar dy kritere bazë për rekomandimet që kemi bërë për Kuvendin. Kriteri i parë janë ato kushtet ligjore që parahinen për zgjedhjen e cilësin e gjyqëtarit dhe prokurorit ato kushte janë të ketë kryer

Fakultetin e Drejtësisë dhe të ketë dhënë provimin e jurisprudencës për gjersa për vendin e punës dhe kushti i dytë që ka caktuar komisioni është që kandidatët që zgjedhen dhe propozohen në periudhen e zbatimit të ligjeve represive të mos kenë punuar në organet e gjyqësisë, në periudhën prej rënimit të organeve të Kosovës prej vitit 1991-98. Komisioni me rastin e dhënies së këtij propozimi ka kërkuar të dhëna konkrete nga komisioni prokurant dhe gjyqësorë për plotësimin e këtyre kushteve për kandidatët e propozuar dhe për kandidatët që i keni të rekomanduar për zgjedhje, kanë marrë prova relevante se kandidatët i plotësojnë këto kushte.

Ndërsa, kandidatët e tjerë që i keni të rekomanduar të mos zgjedhen. Në këtë mbledhje komisioni ka propozuar që për këta kandidatë të mbledhen të dhëna plotësuese, ndërkohë për disa nga kandidatët kanë ardhur të dhëna plotësuese dhe komisioni është i gatshëm që në mbledhjen e ardhëshme të Kuvendit të bëjë edhe propozimin për zgjedhjen e kandidatëve. Kështu që nuk duhet të merret se kandidatët janë refuzuar, përkundrazi për ta nuk ka pasur prova të mjaftueshme për përvojën e tyre gjatë kësaj periudhe dhe për kushtet ligjore për zgjedhje. Ne jemi të sigurtë se në mbledhjen e ardhshme mund t'i japim një propozim edhe për kandidatët e mëposhtëm. Ju falemnderit

### **DRITON LAJÇI,**

E nderuar Kryesi, i nderuar Kryeministër dhe ministra dhe ju kolegë,  
Grupi parlamentar i PD sot në orën 10 është takuar dhe ka diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës, brendapërbrenda grupit tonë, Shkresa e çila ka ardhur nga komisioni mendoj se nuk është e përgatitur si duhet. Ne nuk kemi informacione të plota të bollshme për kandidatët për gjyqëtarë, të cilët vijnë nga komunat e ndryshme. Ne kemi një shkresë, edhe sqarimin tim e paraqes në pikën 9.4.7 të Kornizës Kushtetuese ku thuhet se duhet të jenë me karakter moral dhe me kualifikim përkatës. Ne nuk kemi informacion, ne nuk kemi biografi për asnjerin nga kandidatët, pavarësisht prej asaj se edhe propozimi vjen nga komisioni i cili i takon PD. Mendoj se këto parime duhet të respektohen dhe mendoj se kjo pikë e rendit të ditës nuk është përfillët si duhet dhe ne jemi marrë vesh se grupi parlamentar i PD të apstenojë deri sa të bihen informacionet e bollshme autobiografia e punës së tyre puna e tyre në gjykatë dhe kush janë ata njerëz.

Ne i njohim vetëm si emrat për mua personalisht dhe për grupin tonë kjo nuk është e mjaftueshme. Ju falemnderit.

### **RAMADAN KELMENDI**

I nderuari kryetar, Kryesi, deputetë, ministër dhe kryeministër,

Ky propozim gjegjësish ky rekomandim është i mangët nga fakti se shumica e këtyre juristëve të përcaktuar për gjyqëtarë dhe prokurorë mendoj se mungon biografia, Ju e dini se këtu keni zgjedhur përveç kryetarit të Kosovës që na është lexuar biografia për të gjitha funksionet nuk na është lexuar biografia. Ne e njohim njeri tjetrin, parimisht nuk qëndron ashtu. Duhet të ishte biografia për secilin gjyqëtar, kushtet, puna dhe përvoja në punë, si dhe implikimi i tyre në procedurat gjyqësore paraprake. Unë kam këtu emrat, nuk do t'i përmendi, në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, të cilat kanë marrë vendimet gjyqësore të plotëfuqishme gjatë periudhës diskriminuese mbi shqiptarët, prandaj po të ishte biografia për secilinë shum më lehtë do të ishte ta themi fjalën e vërtetë. E dyta, nuk është argumentuar pse të tjerët nuk janë rekomandu që sot të zgjedhen. Mendoj që për çdo funksion duhet të jipet biografia kontributi, kushtet dhe kriteret për emërim. Ju falemnderit.

### **OLIVER IVANOVIĆ KP**

Muslim da bi bilo dobro da smo Skupštinu obavestili o tome da smo svi u Predsedništvo prilično podeljeni kod ocene ove liste i naçina kako su ljudi predložili. I tada bila je primedba na Predsedništvu da nemamo podatke, na osnovu kojih bi se mi izjašnjavali da neko ne ispunjava ili ne ispunjava te formalne uslove. Ja danas prvi put čujem koji su bili kriterijumi od predsednika komisije, i mislim da ovaj prvi je svakako kriterijum koji bi se u svako drugom slučaju našao na prvom mestu to su stručni, oni formalni uslovi za imenovanje na funkciju sudsive ili tužioca. Ovi drugi uslovi nešto u čemo bi trebalo diskutovati mëslim a pstrahuje malo svoje političke stavove i za trenutak razmislite o tome. Sudija nije u prilici da tumači da li je zakon ovakav ili onakav, može samo zakon da primenjuje, Isto će i sutra važiti, sudija koji će bude imenovan, će primeniti onakve zakone kako jesu, znači utvrđuje njegova stručnost, njegova sposobnost da proceni na

pravilan način ono što je napisano kao norma kao zakon. Za to i mislim da izjašnjavajući se za ovaj kriterijum da nije učestvovao u pravosudnim organima 91-98 mada mislim da ih nije bilo, jer ja ne znam da li je neko od kandidata učestvovao u pravosudnim organima, ali, kažem da na izvestan način vi uvodite politizaciju ove funkcije. Znači onaj koji se između 91-98 opredelio za jednu političku opciju sada ima šanse da bude sudija, ako se opredelio za suprotnu političku opciju on je apsolutno isključen da bude sudija i ako je ispunjavao uslove, rekao bi profesionalne obaveze na način da je tumačio Zakon kako je napisan. Ja opet hoću da kažem to, da postoje organizacije i da je za mene veoma značajno šta će OEBS reći o ovim kandidatima, oni su ih pratili kroz period od 90 pa do danas. Ne bi bilo loše da smo to imali, i ne bi bila naša, mislim da bi naša odluka u tom slučaju bila daleko kompetentnija, ovako smo mi dovedeni u poziciju da se izjasnimo za one koji su u listi, jesmo za ili protiv i da individualno odlučujemo o tome o simpatijama ili eventualnim saznanjima o kandidatima..

### **BAJRAM KOSUMI AAK**

Të nderuar deputetë Ne dje në Kryesi kur e kemi diskutuar këtë çështje, jemi pajtuar që të futet në seancën e sotme parlamentare, në mënyrë që ju sot të diskutoni dhe të jepni mendimin tuaj. Unë dje jam pajtuar që të futet në procedurë, mirëpo me qenëse ka këtu deputet që i njohin drejtëpërdrejt dhe që kanë mendime të ndryshme nga ato që kanë ardhur nga komisioni, unë pajtohem që sot kjo pikë këtu që mos votohet. Për këtë pikë të vijnë biografitë për secilin kandidat për gjyqëtar. Edhe qëndrimi i Kryesisë dje ka qenë ky që të vijnë biografitë për secilin. Komisioni ka shenimet, mirëpo nevojitet ato të vijnë te ne dhe t'i shofim drejtëpërdrejt. Ky është qëndrimi që do të mbajmë ne tash si grup parlamentar, te kriteret që ka komisioni mendoj se kjo çështje nuk duhet të politizohet, mirëpo pjesëmarrrja në proqeset gjyqësore, pjesëmarrrja në denimin e padrejtë të njerëzve nuk është çështje politike, është çështje e krimít. Ju falemnderit,

### **ISMAJL KURTESHI PDK**

Unë plotësisht pajtohem me vërejtjen e parafolësit se gjykatësit duhet ta kryejnë punën dhe të gjithë ata vërtetë punojnë në bazë të asaj që është e paraparë me ligj të jenë gjykatës, por jam kundër atyre që jamë vu në shërbim të regjimeve diskriminuese dhe

ligjin e kanë pasur vetëm një paravan dhe i kanë shërbyer shërbimeve diskriminuese që nga viti 81 – 99. Ata gjykatës që nuk e kanë kryer punën e gjykatësit, por e kanë kryer punën e politikanit janë vu në shërbim të politikave të tilla, duhet ti kemi biografit e tyre dhe ndaj tyre duhet të kemi vërtetë një shikim kritik. Po ashtu mendoj që duhet të shikohen edhe puna e gjykatësve të cilët janë emëruar gjatë këtyre tri vjtëve të fundit. Ka gjykatës dhe janë një numër i tyre i madh po ashtu nuk i kryejnë punët si duhet i zvarrisin lëndët edhe atëhere kur situatat janë shumë të kjarta. Une e di në komunën time ka raste kur do të duhej të ndërmerr masa ndaj ozupatorëve, ndaj keqëpërdoruesve, por për shkak lidhjeve të ndryshme ata i zvarrisin këto, prandaj për të gjithë gjykatësit nëse vërtet dëshirojmë që gjyqësinë ta kemi në nivelin e duhur ta marrim edhe t'i kemi informatat e duhura. Ju falemnderit.

### **HILMO KANDIĆ BSDAK**

Poštovani predsedniče, poštovane kolege. Ja ëu biti kratak samo sam izašao da se pridružim kolegama koji smatraju da ova tačka dnevnog reda treba biti odložena. Pored svih onih nedostataka, za koje su naveli, ja bi samo još jedan primer dodao, jednostavno, ja sam primetio da na ovoj listi u opšte nema, koju je Predsednik pročitao, predstavnika bošnjačke zajednice. Ja stvarno moram nešto da kažem, što ljudi moje zajednice traže, ovaj, ne znam ko i dalje čini greške, da li je u pitanju naša Kosovska strana ili je u pitanju Međunarodna zajednica. Hvala.

### **SABRI HAMITI LDK**

Edhe nga diskutimi i deritashëm shifet mirë që kjo pikë ashiqare nuk është hartuar mirë dhe nuk është diskutuar paraprakisht në nivelet që kërkojnë LDK. Kërkoj që të mos votohet edhe deputetët edhe situata edhe nevoja unë në emër të grupit parlamentar LDK-së kërkojë që sot mos votohet por këtë çështje kërkoj që Komisioni të plotësojë të gjitha kërkimet e veta dhe rekomandimet të japë të qarta. Kërkoj që të kalojë kjo në kryesi dhe kryesia nëse miret vesh mos dal me mendime të ndryshme këtu, në senacën e ardhshme të votojmë për këto rekomandime. Ju falemnderit.

### **JAKUP KRASNIQI**

Unë do ta shtrojsha një pyetja para Kuvendit para deputetëve për çështjen e kriterit të përvojës, e për çfarë kriteri bëhet pyetje këtu edhe nuk kandidati se paska një përvojës për pesë, dhjetë pesëmbëdhjetëvjeçare të ketë një përparsi ndaj atyre gjykatësëve të rinjë që kanë kryer fakultetin kanë kryer edhe përvojën përkatëse për gjyqtarë, të diskriminojen apo njëfarë përvoje ku në situatën e kriuar të gjithë gjykatësit duhet t'i nënshtrohen trajnimit dhe këtu mendoj që duhet të jenë të barabartë dhe kriteri i përvojës nuk duhet të merret parasysh dhe jo vetëm për këta gjykatës. Ju falemnderit.

## NEXHAT DACI

Më lejoni të përmbyllë këtë pikë të rend të ditës.

Faktografia është kjo Komisioni përkatës të cilin ky Kuvend njëzëri e ka miratuar e ka pasur tërë dokumentacionin emër për emër në dispozicion në mënyrë shumë të argumentuar, të bazuar në të gjitha rregullat e punës të një Komisionit i ka bërë propozim Valent të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Kryesia ka diskutuar gjatë, dhe ka pasur diskutime të ndryshëm, në fund me shumicë votash e ka përkrahur propozimin e Komisionit. Një informatë shtesë që shkon në favor të Komisionit dhe të Kryesisë është kjo. Unë e kam informatën me shkrim, por tani edhe z. sekretar edhe unë e njoftova edhe anëtarin e Kryesisë z. Gjavit Halitin, është lutja që në fund të muajit z. Shtajner me fajin tonë atëherë, jo si më parë, do ta shpall listën komplete të gjykatësve dhe të prokurorëve. Prandaj ju lutem për të gjithë të kuptuarit dhe të gjitha ato që dikush ka mendim tjetër nuk do të thotë që nuk janë të pavendos. Jemi në një situatë të këtillë kohore, i ndëgjuat të gjitha diskutimet. Unë do të kërkojë që nga z. Kosumi ta tërheqë propozimin e vet dhe nga z. Hamiti ta tërheqë propozimin e vet heshtazi dhe të vejë në rend të ditës kush është për propozimin e Komisionit të përkrahur me shumicë vota nga Kryesia e Kuvendit.

Ju lutem numroni, votat ju lutem,

Rezultati i votimit është ky: 38 deputetë kanë votuar për motionin, 15 deputetë kanë votuar kundër motionit, dhe 31 deputetë abstenojnë.

Pika e tretë e rendit të ditës është , prezentimi dhe leximi i parë i projektligjit nr.2002/1 për metodologjinë dhe përcaktimin e nivelit të pensionit në Kosovë dhe caktimi i datës për fillimin e pagesës për pensionin themelor, e besoj fjalën do ta merr z. kryeministër,

### **BAJRAM REXHEPI, kryeministër i Kosovës**

I nderuari kryetar, të nderuarë delegatë,

Pas një kohe të konsolidimit të Qeverisë por edhe të Parlamentit na kemi filluar një angazhim maksimal rrëth përpilimit të drafë ligjeve ku një ndër më prioritaret ose të parët janë edhe ligji për pensionet bazike ose themlore, meqenëse është paraparë edhe në programin qeveritar që prej një korrikut të fillojë një lloj pagese për pensionistët të cilët janë mbi moshën 65 vjeçare. Unë këtu kisha dashur ta përmendi vetëm mënyrën e përpilimit të draf ligjit dhe skemën pensionale në të cilën na jemi bazuar në bazë të rregullores 2001/35. Mendojmë se ligji themelor për pensionet është një hap i rëndësishëm për tju siguruar një kontribut të gjithë Kosovarëve të kualifikuar në moshën e shtyer mbi 65 vjeç. Ky ligj është i hartuar sipas rregullores 2001/35 dhe është pjesë e skemës së gjerë pensionale. Skema e pensioneve është e ndërtuar në 3 shtylla . Shtylla e parë, pensioni thejmelor është i obligueshëm dhe ka për qëllim që të sigurojë një minimum apsolut të të ardhurave për të gjithë personat e moshuar pavarësisht a kanë punuar a jo, pra mendohet në personat mbi 65 vjeç.

Shtylla e dytë, pensionet nga fondi i kursimeve që është i obligueshëm dhe që gjithashtu krijohet sipas rregullores 2001/35. Ky do të jetë burimi themelor i të ardhurave dhe do të paguhet nga fondi në të cilin punëtorët do të kontribuojnë gjatë punës së tyre. Kjo formë në të ardhmen e afërtë do të jetë edhe si formë e sigurimit të tyre.

Shtylla e tretë, fondi vullnetar i kursimeve gjithashtu i krijuar sipas rregullores 2001/35, siç thotë emëri një fond në të cilin punëtori mund të kontribuojë gjatë punës së tij për të shtuar pensionin të cilin ai e merr sipas shtyllave 1 dhe 2 pas pensionimit. Si karakteristikë e përgjithshme e tërë ligjit për pensionet, pensionet zhvillohen sipas skemës paguhen derisa atë shkoj, se dmth. se ata paguajnë përpensionet e tyre gjatë punës. Kjo është metodologja e pranuar në të gjitha shtetet në tranzicion dhe e cila garanton që skema e pensioneve do të jetë e qëndrueshme gjatë 30-40 vjetëve. Këtu kisha dashur edhe një sqarim. Na kemi pasur kontakte me pensionistët invalidor. Kjo

është një kategori e cila nuk është përfëshirë në këtë ligj, mirëpo në bazë të rregullores 2001/35 kur ka filluar skema pensionale nuk është paraparë kjo kategori. Ne në Qeveri kemi paraparë se duhet të fillojë përpilimi i drafëligjit edhe kjo kategori e pensionistëve që pa të drejtë është nuk është përfshirë në këtë skemë pensionale, duhet të përfshihen dhe mendoj që do të jetë një procedurë që gjatë vitit duhet të përpilohet draf ligji që ndaras edhe këta të kyqen në skemën pensionale.

Po ashtu, ne kemi filluar këtë përgaditje të ligjit pa u bazuar në fonde pensionale, të cilat janë të plaqkitura ose kanë mbetur në Serbi. Shpeshëherë nga pensionistët kërkohet se ato fonde nuk kthehen në Kosovë, kjo nuk është në kompetencën e Qeverisë, na kemi përgadit strategji. Kemi bërë kërkesa, mirëpo ndoshta realizimi mund të bëhet bashkarisht, vetëm me UNMIK-un për arsyet se ato fonde pensionale ku punëtorët tanë i kanë dhënë kontributet e tyre gjatë punës pa të drejtë janë usurpuar dhe kanë mbetur në Serbi. Ka qenë obligim që ato t'i dorëzohen UNMIK-ut dhe UNMIK-u ta bëjë distribuimin e tyre. Nëse na arrijmë që ato fonde t'i kthejmë në Kosovë, atëherë do të shkojmë me destinimin e caktuar do t'iu jipet atyre pensionistëve të cilët i kanë realizuar gjatë punës së tyre gjatë themelimit të këtyre fondeve. Mirëpo, sikur ne të presim sqarimin e tyre ne kishim për t'u vonuar me këtë skemë pensionale dhe do të shkonte edhe një vit dy pa pasur mundësi që të fillojë, megjithate një llojë kompenzimi në këtë moshë mbi 65 vjeç.

Kisha dashur të kthehem edhe një herë, në ligjin themelor për pensione Sipas regullores 2001/35 për pensionet në Kosovë, Kuvendi duhet të vendosë për metodologjinë që përcakton shumën e pensionit themelor. Kjo duhet të bëhet në atë mënyrë që e njejta shkallë të vlejë për pensionistët e kualifikur sipas moshës e që shkalla për vitin pasues të bëhet gjatë procesit buxhetor brenda kufijve të fondeve të përgjithshme të përcaktuara për institucionet e përkohëshme të vetëqeverisjes, për pensionet themelore për të moshuar nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, që të provojë t'ia thjeshtësojë këto pensione ndryshime gjatë një viti fiskal nuk mudë të ndrohen kurse gjatë përpilimit të buxhetit për vitin e ardhëshëm varësisht nga mundësitë buxhetore mund të bëhet rritja e këtyre pensioneve. Për detaje më tej ministri Jusufi do të bëjë prezentimin më detaj përligjin themelor mbi pensionet dhe do të laborojë metodologjinë dhe shumën e pensioneve themelore. Megjithate dëshiroj të theksoj disa pikë, arsyeta pse ky pension

themelor është shumë i vogël, edhe na pajtohem i se është i vogël 28 euro që nuk mjafton për të krijuar egzistencë. Arsyja kryesore e jonë ëshët kufizimet buxhetore, buxheti i konsileduar i Kosovës është tejet i kufizuar dhe nuk mund të përballojë ngritje të shumës sipas ligjit themelor për pensione. Një pikë tjetër, familjet e varfëra ose të them më të varfëra gjithashtu mud të mbështetën edhe një mirëqenien sociale që plotëson të ardhurave e tyre, pra do të ketë forma tjera të ndihmës shtesë të këtyre rasteve sociale. Grupet speciale të interesit. Qeveria e njeh pozitën e tyre të veçantë në shoqëri, megjithatë inkorporimi i tyre me ligjin themelor për pensione do të rënonte natyrën univerzale të ligjit, përgjigje në shqetësimet e tyre dhe gjendjen e tyre financiare socilale duhet të vijë nga skema e ndryshme sociale, Qeveria është e gatshme që të shohë se qfarë mundë të bëhet për ta. Pra ekzistojnë disa kategori sociale të cilat nuk janë të kualifikuara që të marrin pjesë në skemën pensionale dhe për to do të përpilohen ligjet tjera të cilat mendojmë se deri kah shtatori do të jenë të gatshme të përcjellura në Parlament, edhe në fund që mos t'ju marr kohë. Urgjenca, pensionet themelore parashihen të fillojnë me një korrik. Lus Kuvendin që për hirë të personave të pensionuar në bazë të moshës që kanë nevojë tejet të madhe të miratojë ligjin ashtu që pagesat të mund të fillojnë sa më parë që është e mundur.. Ju falemnderit.

### AHMET JUSUFI AAK

I nderuari kryetar, të nderuarë deputetë,

Para jush po prezantojë sa më qartë..nr. 2001/35 të 22 dhjetorit 2001, sistemi pensional që po krijohet në Kosovë. Është konceptuar që në të ardhmen është 3 shtyllësh.

Do të përbëhet nga pensioni themelor, pensioni kursimor, dhe pensioni suplementar, apo vullnetar. Ne në këtë fazë të zhvillimit tonë shoqëror nëpërmjet të këtij projektligji projeksojmë vetëm shtyllën e parë të këtij sistemi, që do të thotë po punojmë për shtyllat tjera. Pensioni themelor për rrethanat e tanishme që po kalojmë si shoqëri në tranzicion është një zgjidhje e pranueshme dhe plotësisht e realizuar. Në kontekstin e sotëm shoqëror të vendit tonë, pensioni themelor ka për qëllim sigurimin e minimumit jetësor të qytetarëve të moshuar të Kosovës dhe pagesa e tij sigurohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Të drejtën e pensionit themelor e gjëzojnë gjithë qytetarët e Kosovës që kanë mbushur 65 vjet pa asnjë dallim. Për hirë të informimit sa më të saktë dua të them se ky

pension nuk ndërlidhet me asnjë mënyrë me kontributet se qytetarët e Kosovës i kishin paguar përvite me radhë në të kaluarën. Fondi i mëparshëm i pensioneve, sikundër edhe shumë të mira tjera materiale të krijuara me mund dhe ndjersën e qytetarëve si përfundim ka pasur plaçkitjen nga Serbia.

E drejta e pensionit themelor nuk e abrogon të drejtën e paguesve të rregullë të kontributeve për dekada me radhë. Të gjithë ne duhet të përpinqemi që fondin padrejtësish të grabitur t'ua kthejmë pronarëve të tyre të vërtetë.

Lartësia e pensionit themelor përvitin 2002 është paraparë të jetë 28 euro, në muaj, kurse përvitet e ardhshme Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të përgatisë një vlerësim vjetor, lidhur me shpenzimet mesatare mujore të shportës ushqimore me kalori minimale.

Kur e them këtë e kam përdetyrë të sqaroj. Me rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 ka qenë e paraparë 20 euro, ndërsa posa jam emëruar për postin e ministrit kam thanë se do të bëjë një hap përpara. Kam hulumtuar materiale të ndryshme në të cilat do të bazoja dhe ngritjen e këtij themelor apo pension pleqërie apo si doni quani, por është një ndihmë elementare që garanton një jetë minimale në nivelin e rezikshmërisë po e them.

Përvitin 2002 nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, janë akonduar 17 milionë euro, që do të mjaftonin përpagesën 6 mujore të njëqindë e tridhjetë mijë pensionistëve, ndërsa unë kam kërkuar që nga sufici i vitit të kaluar të lejohet edhe shuma e tjetër 6 milion euro dhe kemi 22 milion euro nga buxheti i Kosovës që është 350 milionë euro. Data e fillimit të pagesës së pensioneve themelore parashihet të jetë 1 korriku i këtij viti, ndërsa përpensionistët që përsye të ndryshme nuk do të aplikohen me kohë do të jetë afati deri me 31 tetor. Përaplikim në mënyrë të t'i marrin rektroaktivisht nga 1 korrikuk dmth. nuk e humbin drejtën, qoftë edhe me 31 korrik aplikojnë ata përsëri do të gëzojnë drejtën e pensioneve.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale edhe pse me vështirësi të mëdha përnjë kohë të shkurtër ka krijuar kushte të nevojshme që pagesa e pensioneve themelore të fillojë me 1 korrik. Është krijuar administrata pensionale e Kosovës, në të cilën janë të inkuadruar kuadro adekuate. Gjithashtu janë hapur qendrat rajonale të administratës së pensioneve.

Në kuadër të aktivitetave të ngjeshura nisur sa më të mbarë të dhënieve të pensioneve, një punë tjeter është bërë sa i përket aspektit administrativ. Janë shpërndarë aplikacionet dhe fletushkat pensionistëve dhe kemi nisur me pranimin dhe përpunimin e tyre. Pagesa e pensioneve themelore është paraparë që të bëhet nëpërmes bankave që veprojnë në Kosovë, me të cilat Ministria e Punës dhe Mirëqenis Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave kanë nënshkruar një memorandum, sipas të cilit bankat që afarojnë në territorin e Kosovës janë të obliguar që pensionistëve t'ua hapin falas xhillogaritë përmes administratës së pensioneve të Kosovës dhe që shërbimet e shpërndarjes së pensioneve t'i bëjnë gjithashtu falas.

Unë dhe Ministria që drejojmë jemi të vetëdijshëm që shuma e propozuar nuk e përbënë as minimunin e ekzistencës të një pensionisti në Kosovë dhe si e tillë është larg optimumit të egzistecës, mirëpo e ardhëmja më e mirë për pensionistët e Kosovës kushtëzohet nga faktorët që kanë të bëjnë me një zhvillim më të përparuar ekonomiko-shoqëror të vendit tonë.

Të nderuar depuetetë. Ajo që do të vendos për miratimin e këtij projektligji dhe përlartësinë e pensionit është vota juaj,

## **NEXHAT DACI**

Ju falemnderit z. Ministër. Besoj që kryetari i komisionit për çështje sociale mund të ketë një fjalë,

(Nuk e kan treguar emerin e folses)

I ndaruari Kryetar të nderuar deputetë,

Komisioni për punë dhe mirëqenie sociale, e ka pasur këtë drafligj në dorë, mirëpo kryetarja e ka pasur materialin nuk e ka hudhë në rend të ditës në mbledhje të komisionit para rrugës së saj në Amerikë. Ne kemi pasur anëtarë të tjera edhe pse nuk ka qenë në rend të ditës, ne anëtarët e tjera të komisionve kemi vënë disa vërejtje lidhur me këte.

Ne anëtarëve të komisionit si dhe të gjithë që jeni këtu prezantë është dashur t'ju ofrohet më herët rregullorja për pensionet, të cilën e ka aprovuar, të informoheni se lidhur me çka ka të bëjë kjo rregullore. Unë propozoj sot që Parlamenti i Kosovës dhe Ministria e Punëve të Mirëqenies Sociale ta përpunojë edhe një herë këtë rregullore dhe ta kemi një ligj për pensionet, se unë nuk jam juriste. Besomëni, por nuk e di se si dalin drafligjet dhe

ligjet me irregulloret nuk mirem vesh, për të dalë një drafligi për punëtorët dhe të shkojë në diskutim publik dhe të shkojë në Parlament, kurse ne si komision kemi pasur mjaft kërkesa, mbi 20 kërkesa të pensionistëve të Kosovës të të gjitha komunave me pothuajse me kërkesat e njejtë që lartësia e këtij pensioni mos të pranohet se është shumë e ulët, dhe se nëse është e vërtetë atje se me 28 euro sigurohen 2100 kalori se me 28 euro në muaj mund të blejë 1 kg. Bukë, një litër qumësht, një artikuj ose dy artikuj tjerë besoj nëse kaloritë fitohen veç me bukë që ne shqiptarët do të kemi mjaft kalori se na shpenzojmë mjaft bukë këtu. Mund të them në emër të shumicës së anëtarëve të komisionit, sepse në komision nuk kemi mundur të bien vendime për shkak të mos punës së kryetarit të komisionit, mirëpo në emër të kryetarit të komisionit në këtë parlament kërkoj nga Qeveria që të bëjë çmos, së paku, sepse shumica e gjëra sa e shoh unë apo ne kemi filluar ta mësojmë një lloj praktike nga të huajët që t'i bëjmë gjitha përgatitjet tjera lidhur e një gjëje ma në fund të aprovohet ajo çështje dhe kërkoj nga deputetët e Parlamentit dhe nga Qeveria që të bëjë çmos të sigurohen mjete, dhe kjo shumë fillesatare të rritet, kurse ju shokë zotërinjë ose zonja apo deputetë, kjo lartësi mos të aprovohet apo të propozojmë një lartësi prej bile sëpaku 40 euro. Gjithashtu nga pensionistët kemi vërejtje. Që i muorëm disa sqarime nga Ministria dhe z. kryeministri dhe pastaj, shumë e shumë vërejtje të tjera. Mirëpo unë e shohë në shkallë të parë e vetëm një përparësi dhe një të mirë, sepse, dhe ajo është një numër i madh i femrave shqiptare, sepse nuk kanë punuar kurrë në jetën e tyre, sepse nuk kanë pasur mundësi as të shkollohen, as të punojnë, ato në fund të jetës të gëzojnë një pensio, kështu minimal. Edhe një herë kërkoj ta ngrisim lartësinë e këtij pensionit. Ju falemnderit.

## **DRAGIŠA KRSTOVIĆ**

Gospodine Predsedniče Vlade, dame i gospodo članovi Skupštine.

Ja sam Predsednik Skupštinske Komisije, za prava i interese zajednica. Ovaj Nacrt zakona je bio razmatran na jednoj od prethodnim sednica ove skupštinske komisije, i ja odgovorno mogu da vam kažem da ovaj Zakon na toj Komisiji nije dobio prolaz. Dakle, Komisija je odlučila da zakon bude vraćen Vladi, odnosno predlagaču i zbog pravno tehničkih, odnosno formalno - pravinih razloga na jedan ozbiljniji rad, odnosno da ozbiljniji Zakon bude prezentiran Skupštini na razmatranje i usvajanje.

Osim tih suštinskih primedbi, koje su date na Zakon i formalne pravnih da je jedna primedba i na ovaj pojašnjavajući memorandum, kakoje material nazvan, naime, na drugoj strani tog momeranduma, u skladu sa ovim odredbama. Nacrt zakona predlaže isplatu osnovnih penzijama osobama stalno nastanjenim na Kosovu itd. Stavljena je primedba da to objašnjenje nije dobro i da se na taj način može se vršiti diskriminacija po onom velikom broju ljudi koji iz poznatih okolnosti žive van Kosova, to sigurno je jedna cifra od jedno 10 do 15 hiljada tih ljudi. Ta primedba je dobila podršku na Komisiji i rečeno je da bi zaista to bilo pravo da se penzije koje su predviđene za sve građane Kosova, dakle, za sve one koji status stanovnika Kosova imali na dan 10 juna 1999. godine. Hvala

### **BAJRAM KOSUMI AAK**

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Dëshiroj që diskutimi për këtë çështje kaq të ndieshme mos të shndërohet në fushatë zgjedhore këtu, të përmendin shifra kaq e kaq, pa e ditur buxheti i Kosovës sa është. Nëse propozon sa duhet të jetë pensioni caktoje prej cilës pjesë të buxhetit do ta marrë që të rriten këto pensione. Edhe unë jam që të rriten këto pensione, por duhet ta defilojmë prej cilës pjesë të buxhetit dhe këto do t'ia lëmë Qeverisë që ta shikojë buxhetin, kam shikuar buxhetin, kam shikuar shifrat zyrtare dhe e di që ka mjete që mund të rritet ky pension.

Mirëpo, Qeveria duhet ta caktoj si dhe qysh. Unë dëshiroj që të them se ky projektligj nuk i zgjidh të gjitha problemet lidhur me pensionistët. Më vjen mirë që ministri dhe kryeministri që e sçaruan se çka nuk përfshihet në këtë projektligjë, sepse kjo ka krijuar moskuptime të mëdha tek popullata, sidomos tek pensionistët. Ky projektligj nuk e zgjidh çështjen e pensionistëve që kanë qenë dhe janë në Kosovë. Nuk e zgjidh çështjen invalidore, nuk e zgjidh çështjen e pensioneve familjare, pensioneve të punës, nuk janë të përfshirë këtu. Ky është një pension i veçantë, i cili deri më sot në Kosovë nuk ka egzistuar. Prandaj, ne si grup parlamentar do ta përkrahim këtë projektligj dhe do të votojmë për këtë projektligj me disa vërejtje, e vërejtjet kanë të bëjë me këtë.

1. Që Qeveria të shikojë ta rrisë shumën e këtij pensioni, sepse vërtetë me 28 euro nuk mund të jetohet as kushtet elementare ti mbijetojë një individ ja thash për një individ.

2. Vërejtjet e dyta ose sygjerimet e dyta dhe me radhë janë: Që Qeveria e Kosovës me bashkëpunim me përfaqësuesin special të sekretarin gjeneral të ndërmarrë nisjen e kthimit të fondit të pensioneve të Kosovës të plaçkitur nga Qeveria e Beogradit Ai fond u takon pensionistëve të Kosovës, nuk është fond i Serbisë. Është fond i Kosovës dhe punëtorët, qytetarët e Kosovës kanë kontribuar në atë fond dhe këte edhe me ligj edhe me gjyq se çfarëdo forme ju takon pensionistëve të Kosovës.

Poashtu kërkoj që Qeveria të fillojë procedurën e hartimit projektligjit për pensionet e invalidët e luftës, për pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe fëmijëve jetim, për të cilët sot kujdesen vetëm shoqatat humanitare. Dhe në fund dëshiroj që ta them anën pozitive, atë që e ndiej si qytetar i Kosovës për këtë projekltigj.

Është hera e parë që në Kosovë me një ligj jipet një satisfaksion i madh për qytetarët e Kosovës, për një numër të madh të qytetarëve të Kosovës, të cilët jo vetëm për 40 vjet e jo vetëm për 10 vjetët e fundit, por më shumë se 40 vjet kanë qenë të diskriminuar nuk kanë pasur të drejtën e punës, qoftë për shkak të varfërisë qoftë për shkaqe politike. Unë njoh me qindëra, mijëra njerëz të cilët me vendime të veçanta të gjyqit, të cilët e kanë pasur të ndaluar të punojnë brenda kufijve të ish-Jugosllavis. Vërtet, kjo shumë është simbolike 28 euro por mesazhi politik, mesazhi human i këtij projektligji për gjithë qytetarët e Kosovës për tërë periudhën e kaluar është shumë i madh dhe unë falenderoj Qeverinë që ka ndërmarrë një hap të tillë. Dhe krejt në fund dëshiroj t'i sygjerojë Qeverisë, sidomos ministrit që ta kontrollojë administratën komunale që e kanë krijuar. Ajo administratë ka vështirësi dhe nuk është duke pranuar aplikacione. Ju lutem merrni masa dhe shikoni. Kjo çështje është bërë shumë popullore. Tash njerëzit po aplikojnë e administrata nuk po i pranon. Ju falemnderit.

## NEXHAT DACI

Sot nuk do të votohet për miratimin e ligjit, sot është dëgjimi i parë, leximi i parë. Unë mendoj se ka pasur shumë propozime konstruktive. Diskutuesit e tjera, që janë 20 e më tepër, krejt deputetët do të diskutojnë. Është thënë që mos t'i përsërisim dhe ne do të rezimojmë. Pastaj në fund të kësaj, si vërejtje të përgjithshme që ministria do t'i ketë dhe në seancën e parë do të miratojmë ligjin. Ju lutemi, ta keni këtë parasysh.

## **LILJANA KENIĆ KP**

Poštovani poslanici,

Mi u početku već smo se izjasnili, da ne možemo da komentarišemo puno oko ovog predloženog Nacrtu zakona. Obzirom da nismo dobili uredbu na koju se ovaj Nacrt zakona (zasniva uredbu 2001/35) i da izvršimo određena poređenja, međutim iz pročitanog teksta, ipak možemo (ovaj) da damo od prilike neke kraće kometare i to, da je recimo Zakon i u formalnom i materijalnom smislu dosta nejasani tako, niti koncizan, ima dosta nepotrebnih stvari, a bitnije stvari date su više u pojašnjenu nego što su date u samom Zakonu. Recimo, oko ispunjavanja uslova u Nacrtu zakona, u sekciji 1 kaže penzioneri koji ispunjavaju uslove, nisu dati koji su ti uslovi, uslovi su dati dakle u pojašnjenu gde u gaže: u skladu sa ovim odredbama nacrt zakona predlaže isplatu penzija osobama stalno naseljenim na Kosovu, onda koji je iznos, to bi trebalo da stoji u nacrtu zakona. Zatim..... sekcijski dva, takođe u obrazloženju, date su nepotrebni komentari o potrošačkoj korpi, da i to trebalo da se izmeni, dakle o sekciji tri, oko ovlašćenja ministarsva finansija i ekonomije rekla bi da, ministarstvo finansije ne može doneti zakone. Ministarstva i Vlada mogu da donesu podzakonske akte, trebalo da se ovo izbriše.

Imaćemo sigurno izmene i dopune, koje će se Koalicija, Povratak da predloži. Ja bih na kraju dodala i bi molila g. Rexhepi da ne risti teške reči od strane Srbije, jer ipak, ne pristoji predsedniku vlade da upotrebi takve reči u svakom slučaju sporazum uvek može da se pristigne sa Vladom republike Srbije i sa Specijalnim predstavnikom generalnog sekretara. Hvala.

## **NEXHAT DACI**

I lus të gjithë deputetët që të mos mundohen t'i ndaj në leksione as kryetarit të Qeverisë, as ministrit, lë ta shprehë gjithkush, në të ardhshmen mendimin e vetë dhe i lus për abstenim. Sot është dëgjimi i parë, t'i reduktojmë diskutimet. Urdhëroni.

## **XHAVIT HALITI PDK**

Të ndëruar z. Kryetar, të ndëruar përfaqësues të Qeverisë,

Më vjen mirë që parlamenti i Kosovës po hynë në fazën e miratimeve të ligjeve të propozuara nga Qeveria. Kësaj radhe do të flasë në emër të qëndrimit të grupeve parlamentare të PDK të cilat mbështesim ligjin, kuptohet përpos vërejtjeve që ka, por njëkohësisht duke ditur edhe mundësitë dhe kompetenca ligjore që i ka qoftë ministria përkatëse, qoftë Parlamenti. Vërejtjet themelore mbaze janë tek shuma. Kur është fjala, shuma prej 28 eurosh, ne kërkojmë që kjo mos të futet në ligj, por kjo të jetë një vendim i Qeverisë i cili mund të ndryshojë konform ndryshimit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Mendoj se qoftë Qeveria e Kosovës, qoftë mekanizmat ndërkombëtarë këtu që janë të udhëhequr nga UNMIK-u i kanë shpallur luftë edhe kontrabandës edhe keqëperdorimeve, qoftë në dogana, qoftë tek grumbullimi i taksave dhe tatimeve dhe konform kësaj mendoj se në qoftëse në të vërtetë do të funksionojnë qendrimet e tyre dhe lufta kundër keqëperdorimeve në planin finansiar do të ketë sukses në Kosovë dhe mendoj që edhe buxheti i Kosovës mund të rritet dhe pensionet mund të shtohen.

Në përgjithësi kemi pasur vërejtje nga pensionistët të cilët kanë participuar përpara në gjetjen e kursimeve të pensioneve të cilët kanë dhanë vërejtje që ne nuk mund të barazohemi me ata që nuk kanë punuar dhe nuk kanë marrë pjesë në këtë buxhet. Ne e dimë që as njëna palë as tjetra nuk është tanë duke e shfrytëzuar ish buxhetin e kursyer, dhe është një vullnet i mirë i këtij Parlamenti dhe i Qeverisë që të të inicojë një çështje rregullative, një çështje që asnjëherë në këtë truall, në këtë vend nuk ka qenë e praktikuar, do të thotë mbështetja e njerëzve të moshuar ose ashtu siç e ka krejt bota, tju sigurojë të moshuarve pensionini. Prandaj si grup parlamentar, ne e mbështesim ligjin konform vërejtjeve dhe mendojmë që në proces mund të këtë hapsirë që të plotësohet ligji i propozuar nga Qeveria.

Ju falemdnerit

### **FATMIR SEJDIU, LDK**

Mendoj se jemi pikërisht në momentin që Kuvendi i Kosovës gradualisht themi pak dhe me përgatitje do të hyjmë në fazën e veprimtarisë së tij të drejtpërdrejtë të legjislacionit, dhe iniciativa e marrë nga drafti i përgatitur nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale është një hap i mirë që duhet përshëndetur, duke mos u lëshuar në vërejtje që u dhanë apo kërkesat të një varg deputetësh më herët se bashkë me këtë iniciativë edhe me këtë hap, në

mënyrë urgjente të përgatiten edhe draftet që kanë të bëjnë kategori të tjera. Me që kjo kategori, sipas fjalimeve është një kategori e ndarë dhe që koïncidon apo përputhet plotësisht me masa të ngjashme që meren në shtetet evroperendimore, unë do të ndalesha vetëm për dy - tri çështje të tjera, të cilat kanë të bëjnë me punën apo praktikisht me draftin. E para unë kujtoj se secili prej deputetëve i kanë rregulloret e UNMIK-ut në një dosje të posaçme që është ofruar dhe do t'i lusja që të hulumtojnë që brenda tyre gjendet secila nga rregulloret e miratuara nga përfaqësuesi special dhe që lidhen apo përputhen, mund të jenë edhe mbështetje për këtë ligj dhe sigurisht në hapat e tjerë të mëvonshëm të ligjshëm të legjisacionit.

Qështja e dytë. Konsideroj se ne duhet të përcjellim një rregull. Besoj në hapat e mëtutjeshëm të punës, zakonisht bisedohet në leximin e parë, çështjet në parim, arsyeshmëria e nxjerrjes të tillë që jipet edhe n ga propozuesi mund të jetë edhe nga radha e deputetëve edhe asociacionet e tjera dhe pastaj shkohet në pjesën komplete të analizës së përbajtjes që ka drafti i afuar. Si do që të jetë, mendoj se për arsyeshëmërinë e miratimit të një akti të tillë, mendoj se të gjithë pajtohem i dëshë i domosdoshëm që në një procedurë të shpejtuar duke respektuar edhe normën ta miratojmë në Kuvend.

Qështja e dytë është ajo që ka të bëjë me pikërisht pjesën e masën apo shumës pensionale që jipet si propozim nga ana e Qeverisë. Unë mendoj se është përshtypje e përgjithshme edhe në punën e përgjithshme të komisioneve që kemi bërë edhe më herët dhe nga ato që mund t'i quajmë dhe mund t'i dëgjojmë vazhdimisht edhe reagimet e qytetarëve edhe atyre që dedikohet që është shumë e pamjaftueshme dhe mbi këtë bazë duke pasur parasysh edhe pjesën e mëvonshme, mund të mirret vetëm se në analizë të mëvonshme duke patur parasysh se në rekomandimin e Kuvendit të Kosovës se nuk pajtohet me një shumë të tillë. Qeveria duhet të nxjerë vendim konform aftësive buxhetore që ta mbulojë këte. Kjo ka të bëjë poashtu edhe me pjesën e kalorisë. Ndoshta nuk është në natyrën e ligjit të mbajë diçka të tillë, po është pjesë e një vendimit të posaçëm të përcillet apo e një arsyetimi të posaqëm bashkë me të sikur që është dhënë në arsyetimin bashkë me draftin.

Qështje tjetër është ajo që ka të bëjë me materien si pjesë e shtrimit. Unë kujtoj se disa nga vërejtjet ia kam përcjell z. ministër Ahmet Jusufi dhe kujtoj se do të ketë nevojë

rishiqimi apo rishtimi i kësaj, flas për pjesën e teknikës. Nuk mund të shqyrtohet me paragraf, është nen i ky, ky, që përcjellin rregulloret aktuale apo teknologja e re juridike. Nuk mund të shkohet me paragraf, paragrafi është bie nen apo diçka krejt tjetër apo do të ishte tepër e pa pranueshme të shkohet kësosoji. Kam vërejtje konkrete në pjesë të tjera të normës së ofruar në pjesën e paragrafit dy. Unë do ta çuaja nen 2., Do tua përcjell me shkrim. Ju falemnderit.

## **ZOTI ÇERKEZI**

Zonja dhe zotérinj, kryesi e nderuar, Qeveri e nderuar,

Këtë diskutim do ta ndaja në dy pjesë: E para është dëshira e mirë për punë që ka bërë Qeveria, dhe e dyta mendoj që një mbështetje profesionale, e cila do të jetë mbi bazën e çështjes së pensioneve. Mendoj se në këtë formë dhe uroj në radhë të parë që diskutimet tona të mos kenë kaluar shkel e shko siç kanë kaluar deri më tash dhe të merren parasysh dhe të gjënden vend në ligjet në të ardhmen.

Në qoftëse diskutojmë për pensionet, atëherë pensionet duhet të kenë kriter, mosha vendi i punës vitet e punës, çështja e invalidëve që nuk janë të futur të cilët. Ne nuk kemi një mundësi të nxjerrim një ligj për pensionet, atëherë ky nuk është ligj për pensionet. Qëllimi është i mirë për ndihmë dhe do të jetë ndihmë sociale pra unë do të theksoja këtë se në qoftëse bëhet fjalë për ndihmë sociale duhet të ndihmohen të gjithë të moshuarit mbi 65 vjeç, pamvarësish nga puna ose mospuna që kanë bërë dhe në qoftëse diskutohen për pensionistët, atëherë duhet të plotësohen kriteret. Ju falemnderit

## **ARSIM BAJRAMI**

Para se të flasë krejt dy minuta, për ligjin, une dëshiroj ta ngriti një çështje te Kryesia e Parlamentit. Nuk di a është spjeguar mirë, a jemi në leximin e parë apo të dytë të Ligjit. Në fryshtë e Kornizës Kushtetuese ne jemi në leximin e dytë, për shkak se leximi i parë kryhet në komisione parlamentare, pasi që ministria përkatëse ka propozuar draftin e Ligjit dhe ka proceduar në Parlament, atëherë leximi i parë bëhet në komisionin adekuat parlamentar dhe ky Komision së bashku me komisionin kryesor në qoftë se

involvohet, pra komisioni për buxhet dhe komisioni për pakica, mund të paraqes amandamente, dhe amandamentet së bashku me propozimin e Ligjit të prezantohen në Kuvend për leximin e dytë, kështu që unë vleroj se jemi në leximin e dytë të Ligjit ku Kuvendi duhet të debatoj për projektin e propozuar të ligjit nga Qeveria dhe për amandamentet eventuale që janë bërë. Kështu mendoj që në Kryesi nuk është shiquar mirë. Unë pak më parë e konsultova edhe Kornizën Kushtetuese edhe me plotë përgjegjesi do të them se në jemi në leximin e dytë kur dëshitet të votohet. Këtu nuk u prezantu asnjë amandament të Komisionit përkatës as të komisionit kryesor dhe vetëm dy minuta për ligjin, une e përgëzoj Qeverinë dhe Ministrinë përkatëse për një përpjekje serioze që të bëjë diçka për pensionistët. E të gjithë i dimë kufizimet. Ato janë caktuar në buxhetin e konsiloduar të Kosovës por janë kufizuar edhe me Rregulloren e UNMIK-ut e cila ka rregulluar bazën për dhënien e pensioneve. Unë mendoj se Qeveria duhet të mendoj në të ardhme jo fort të largët të pregadis një ligj të plotë për pensione të definojë regullativën për pensione, në mënyrë që të kemi një ligj vërtetë të plotë, pasi që kjo çështje nuk bën pjesë në çështjet e rezervuara ajo është në kompetencën e organeve të Kosovës.

Pra ligjin duhet kuptuar, si diçka real duke pasur parasysh rrethanat. Ajo që unë angazhohem edhe me çka po përfundojë, është që çështja e caktimit të lartësisë të pensioneve dhe e kalorive mos të jetë kategori ligjore, por të jetë fleksibile, t'i lihet mundësi Qeverisë që varsisht nga rritja e buxhetit të Kosovës të ndërhyjë, përndryshe do të vijmë në në absurd juridik, në qoftë se nesër do të ritet buxheti i Kosovës dhe ka mjete për të ritur bazën e pensionit, ne nuk mujmë me i rritë pensionet pa e ndërruar ligjin. Duhet paraprakisht ta ndrojmë atë dispozitën që e cakton limitin e 28 euro pastaj ta ritim. Mendoj se kjo është e panevojshme, dhe i propozoj ministrisë adekuate të shqyrtojë mundësinë që nga ligji ta hjekë lartësinë e pensionit dhe lartësinë e kalorive dhe këtë ta rregullojë prej rastit në rast me një vendim konkret të saj. Ju falemnderit shumë.

## NEXHAT DACI

Të rezimojmë,

Më lejoni të rezimojmë. Diskutimi numerikisht optimal, vërejtjet dhe sygjerimet të gjitha përbajtsore, mendimi i Kryesisë mendimi i prof. Bajramit, i prof. Sejdiu dhe i shumë

diskutantëve është që të sygjerohet që mos të caktojë me ligj shumën, e dyta mendimi i Kryesisë dhe i gjithë diskutantëve të shqyrtohen mundësitë maksimale, hapsirë ka ende, dhe të lutet Ministria e financave të jetë pak ma përgjegjëse ndaj qytetarëve të Kosovës, kuptohet ndaj përgjegjësive të vetat por, edhe ndaj parlamentit dhe ndaj qytetarëve nevojtarë. Unë e ndaj mendimin e të gjithëve që shuma e propozuar edhe skjarimet t'i dërgojë te kryeministri dhe ministritë është e atillë që parlamenti mund ta menjanojë ligjin mos ta aprovojë, deri në javën e ardhëshme. Sot një javë të bëhen tentime maksimale dhe të theksojë veçanërisht që e përkrahu brengën e koalicionit Kthimi që ligji duhet të vlejë për të gjithë qytetarët e Kosovës që dëshirojnë dhe dojnë të jetojnë në Kosovë, sepse ka shumë qytetarë të Kosovës. Sipas disa të dhënavë të fundit gati 900 mijë qytetarë të Kosovës janë në diasporë, përfshirë edhe qytetarët e Kosovës në Serbinë, Malin e Zi dhe në vendet fqinje prandaj ligji duhet të jetë gjithpërfshirës për të gjithë, Unë kam pasur në rend ditës, po kërkojë falje prof. Bajrami po shkruen lexim i parë, juristët e kanë bërë këte, prandaj nuk është kontestuese dhe si të jetë, unë besoj që Qeveria ka mjaftë argumentime që t'i inkorporojë të gjitha këto dhe ju lus me një votë formale ta aprovojmë për procedurë të mëtejshme i ndëgjuam gjitha këto, dhe i pyes deputetët: Kush është për propozim ligjin për pensionet. T'i ngrisim duart?

Asht propozim që të futet që leximi i parë u bë i suksesshëm jemi të mendimit që të shkojë në aprovim.

Pyes deputetët kush është kundër? Asnjë nuk është kundër, a ka të abstenuar? Ju falemndnerit 1 abstenon.

### **OLIVER IVANOVIĆ**

Mi nemamo formulisane amandmane, ovako to ne ide, ovo je sednica Skupštine. Svaka primedba ukoliko je formulisana kao amandman, ukoliko je amandman, on mora biti tačno prećiziran i da kaže rečenica koja je glasila ovako treba da bude tako, treba drugačije biti formulisana kao amandman. Uprotivnom mislim da ćemo se teško izvući iz ovoga: izvući su zapravo amandmani. Skupština glasa o predloženim amandmanima a zatim o nacrtu Zakona u celini. Ja nemam sliku uopšte kako izgleda šta je usvojeno od amandmana i kako izgleda nacrt Zakona u celini. Ja sam mišljenja, Predsedniče, treba više tolerancije za one koje su članovi Predsedništva kao što je predsednik vlade,

ministri, članovi predsedništva, i šefovi polaničkih grupa i na kraju i predsednici odbora, oni moraju da imaju više vremena jer su i najodgovorniji. Hvala.

### **NEXHAT DACI**

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës,

Propozimi për krijimin e komisioneve të Kuvendit, Komisioni për të zhdukur dhe Komisionit për barazi gjinore, kam vetëm një skjaram. Komisioni për të pagjetur është diskutuar në Kryesi një muaj më parë. Nuk janë pjekur kushtet, prandaj, seanca plenare ka bërë mirë në mbledhjen e fundit që ka inicuar. Kryesia njëzërit e përkrahë këtë dhe i propozohet grupeve parlamentare të propozojmë personat që do ta udhëheqin këtë komision janë caktuar sipas formulës janë krijuar të gjitha komisionet, dhe po ashtu komisionin e kemi quajtur për barazi gjinore prandaj une mendoj që nuk kemi nevojë të debatojmë, unë ju ftojë për një votë formale.

Kush është për konstituimin e këtyre komisioneve ju lutem të votojmë?

ju falemnderit, a ka dikush kundër, asnjë, a ka të abstenuar asnjë, ju falemnderit

Pika e ardhëshme e rendit të ditës është data për pushim veror.

Ne nuk po e quajmë pushim veror. Kryesia ishte njëzërit e mendimit që Kuvendi nuk do të shkojë në pushim veror pa i procesuar të gjitha ligjet që vijnë nga Qeveria si impute për Parlamentin deri sa nuk i kompletojmë ato, prandaj nuk do të caktojmë datë pasi ta kompletojmë punën tonë do të shkojmë në një pushim të caktuar. Unë besoj që të gjithë do të pajtoheni me këtë,

Kush është për këtë, ju falemndnertit, a ka dikush kundër, jo, a abstenon dikush, nuk ka, ju falemnderit, një abstenon.

Do të jap një mendim, në vend të fjalës „të ndryshme“ në rend të ditës herave tjera do të vjenë ”pyetjet e deputetëve“, une besoj që ka pasur shumë pyetje deri tani do të caktojmë në Kryesi një here në muaj apo çdo të tretën mbledhje a çdo mbledhje a pyetjeve të deputetëve për Qeverinë apo nuk keni, keni, urdhëroni z. deputet

### **ISMAIL KURTESHI PDK**

Unë vërtetë nuk kam pyetje por e kam një propozim,

Që pika e rendit të ditës v azhdimisht në m bledhje d he në fillim të m bledhjeve të jetë aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme. Une i kam në dorë procesverbalet të cilat janë karikatur të procesverbaleve, një mbledhje e Kuvendit përmblidhet me një faqe që absolutisht nuk paraqet as paqyron punën e organit. Unë për vete këtu e kam edhe fjalën time dikun të cilën nuk e pranoj si fjalë time sepse asgjë nuk është thënë nga ajo që unë kam dashur të them, prandaj ju lutem kësaj çështje t'i kushtohet rëndësi, përndryshe Kuvendi në të ardhmen do të jetë pa një dokumentacion shumë të rëndësishëm, Ju falemnderit.

## NEXHAT DACI

Në Kryesi njëzërit përkrahet për këtë, është brengosëse për të gjithë strukturën qeverisëse në Kosovë, procesverbalet janë gjithmonë në aspektin gjuhësor analafabet në të gjitha aspektet.

## GANI KOçi PDK

E nderuara Kryesi të nderuar delegatë,

Unë do të lidhem me propozimin e tretë që e dha deputeti Muhamet Kelmendi, rreth situatës në Kosovë. Tash të gjithë jemi dëshmitar të vazhdimit fushatës së egër, mediale policore dhe gjyqësore ndaj gjithë asaj që është quajtur UÇK dhe vlerave historike kombëtare, morale, njerëzore që e ka krijuar ajo, kjo është prekse është dëshpëruese dhe fyese për gjithë gjakun që është derdhur dëshmore, për familjet e tyre për gjithë ata që e mbijetuan luftën, dhe shum ma fyese do të ishte për ne që jemi ulur këtu pikërisht në saje të atij gjaku të dëshmorëve dhe asaj sakrifice që është bërë deri tash, prandaj ky Kuvend ma në fund e ka obligim politik e kombëtar nga ata që e mbajnë drejtësinë në duartë e veta. Cilat janë faktet për fushatën e ndjekjes të pjesëtarëve të UÇK-së tanë eprorë të trupave mbrojtëse të Kosovës dhe gjithë atyre që ishin dhe janë më meritorë për këtë që ne me plotë gojën e quajmë Liri, Ky Kuvend e ka për obligim nga ata që e proklamojnë se askush nuk është mbi ligjin, ta ndalin turmën dhe mos shalojnë ligjin në ndjekjen dhe aresitmin e tyre që dhanë më së shumti që të mbretërojë me të vërtetë rendi dhe ligji.

Ky Kuvend e ka për obligim moral dhe kombëtar të kërkojë nga ruajtësit e rendit dhe të ligjit që ndjekësit dhe arrestimet e njerëzve më të ndërgjegjëshëm dhe akuzat ndaj tyre mos ti bazojnë në konstruksionet denoncimet dhe dëshminë e ish-ubdashve, kolaboracionistve pushtuesit serbë, sabotatorve të luftës së lavdishme të UÇK të Kosovës dhe argatëve të agjenturave serbe, sepse z. deputetë dhe ata që sot ndajnë drejtësinë një gjë duhet ta kemi të qartë, UÇK në fillimin e luftës i ka shpallë luftë okupatorit serbë dhe gjithë bashkëpunëtorëve të këtij okupatori.

Ky Kuvend ka për obligim të kërkojë nga ruajtësit e rendit të ligjit të heqin dorë nga përpjekja për ta njollosur luftën çlirimtare duke akuzuar çlirimtarët se gjoja kanë ba krim mbi qytetarët. Ky Kuvend e ka për obligim nga ruajtësit e rendit të ligjit, pse lufta e shpallur kundër krimit ekonomik, korruptionit, dhe zbulimi i fileve të KEK, PTK të doganave dhe të tjera, ku në këtë krim ishin të përfshirë dhe të implikuar me të madhe ndërkombëtar dhe vendorë, në një çastë muarën kahje tjetër dhe tërë ajo luftë u drejtua te pjesëtarët e TMK-së dhe ish pjesëtarëve të UÇK të Kosovës dhe unë si deputetë për gjithë juve kolegë të nderuar kam një pyetje?

Pse në prag të çdo procesi të veçantë siç janë zgjedhjet komunale ndodhin arrestimet e tillë, dhashtë Zoti që të shpetojmë ndonjë e keqe ma e madhe për të cilët janë mësuar me e përfituar ata që dëshirojnë ato, dhe në fund i propozoj Kryesisë së Kuvendit ta shtrojë këtë çështje për një diskutim të veçantë në një nga seancat e ardhme dhe në atë diskutim të marrin pjesë,

Z. Shtajner, përfaqësuesi i policisë së UNMIK-ut, prokurorisë dhe gjyqësisë së Kosovës, ombuds personi Z. Novicki dhe Gj. Qeku,

Ju falemndnerit.

### **MEVLYDE SARAÇI,**

Unë vetëm desha që ti sygjerojë sekretarisë që të jetë më e vemendëshme gjatë diskutimeve që në procesverbal të 16 prillë të futë edhe diskutimin tim, me këtë rast ju baj me dije se sigurisht edhe ju e dini, se kërkova formimin e komisionit për ata që janë marrë pengë. Unë nuk kam pregadit me shkrim kurgjë, por me shkrim i kanë familjarët personat që i kanë marrur pëngë në Gjakovë fjalë përfjalë që vëtë i kanë xhiru gjatë

gjirimit dhe televizioni që po e ban gjirimin drejtëpërdrejtë e ka këtë material, prandaj unë kam të drejtë si deputete të kërkojë që të jetë në procesverbal edhe diskutimi im.

## **BAJRAM KOSUMI**

Të ndëruar deputetë,

Kam dy pyetje, e para është shumë e shkurtër, pyetjet që u shtruan nga z. Kelmendi dhe z. Koci që të vijnë këtu dhe të jatin sqarime për arrestimet e fundit. Çështja e dytë është që kam është një informacion që unë fatkeqësisht e kam marrur dje me një shkresë të komisionit qendror zgjedhor që është nënshkruar nga z. Arsim Janjova, Haxhi Rama, Akif Sheholli, Shefket Ajrudini, Hamide Konushefci dhe Esat Hafiz, do të thotë shumica e Komisionit Qendror Zgjedhor e ka shkrua një shkresë cila kundërshtohen një vendimtë i ambasadorit Paskal Viesku i cili ka marrë atë vendim duke përdorur drejtën e vet pa e pyetur fare Komisionin Qendror dhe Zgjedhor e i cili vendim i z. ambasador e shkelë rregulloren të cilën e ka nënshkruar vetë e me cilën rregullore i lejohet një partie nuk e di cila parti, partia social demokrate e serbisë ka drejtë të marrë pjesë në zgjedhjet në Kosovë pa u vërtetue në komisionin zgjedhor. Kjo është shkelje e rregullores që ka nënshkruar vetë z. Fiesku është shkelje e Kornizës Kushtetuese është shkelje e krejtë këtij procesi që janë duke bërë rrëth këtyre zgjedhje, prandaj i propozoj Kuvendit dhe në veçanti edhe Kryesisë edhe para Kuvendit që të ftohet z. abasador Fiesku në seancën e ardhëshme plenare dhe të jap sqarime pse ai ka nënshkruar vetë .

## **NEXHAT DACI**

Ke qenë në Kryesi dhe e ke ndëgjuar skjarimin. Ne nuk jemi pajtuar asnjë. Ka thënë që edhe këto zgjedhje i organizon OSB-eja, ejo ne. Unë nuk e kontestojë fare të drejtë, por në në proqesë të cilën nuk marrim pjesë fare, unë e përshëndes shkresën e të gjithë atyre që kanë shkruar diskutimin, por të themi se e kemi kuptuar materien se në të gjitha vendet normale zgjedhjet e një vendi i shpallë parlamenti i atij vendi edhe ato lokale edhe ato nationale, kjo është që ne vazhdimisht po mundohemi që të jemi si parlament të jemi pjesëmarrës të barabartë edhe në ata sektorë ku janë të themi, parlamenti duhet të ifnormohet kërkohet transparencë e plotë e organeve ndërkombëtare me të cilët

parlamenti dëshiron të bashkëpunojë të bashkëunojë mbi bazat e të një partneritetit të denjë dhe jo të subroninohemi.. Ju falemnderit.

### **RAMADAN KELMENDI**

Kur Kuvendi i Kosovës do të vejën në rend dite zgjidhjen e problemit të 16800 punëtorëve shqiptarë të Mitrovicës veriore dëbuar me dhunë nga vendet e tyre të punës, ose kur ata do të paguhen nga se punëtorët serbë që nuk punojnë paguhen nga fondi buxheti i Kosovës.

Çka është kjo, dhe e dyta ku është mbështetja ligjore që një deputeti vjen nga Mitrovica dhe e nuk ka mundësi ta shprehë mendimin për një pikë konkrete, dhe e treta, procesverbali nuk i përmbanë regullat elementare juridike. Ju falemnderit

### **JAKUP KRASNIQI PDK**

Unë fillimisht do të kërkoja që kjo pikë e rendit ditës të jetë pyetje dhe kërkesa.

Unë e kam një kërkesë në nenin 9 pika 9.1 dhe pika 18 me Kornizë Kushtetuese unë propozojë.

Formimin e këtyre komisioneve funksionale. Komisioni profesional për kontrollimin e menaxhimit financiar të ndërmarrjeve publike, si KEK-u, PTK-ja, doganat për periudhën 2 a ma tepër vjeçare, komisioni për tokën dhe pronën, komisioni për media publike konkretisht për RTK-më. Arsyetim,

Për kërkesën e parë. Është folur shumë për krimin ekonomik, korkpcionin në ndërmarrjet publike. Shtajneri paralajmëroi një tolerancë zero, por si duket aktiviteti i tij ka hasur në pengesa nga ata që janë implikuar në këtë dukuri të shëmtuar. Është domosdoshmëri formimi i një komisioni ekspertësh për të hulumtuar si është bërë menaxhimi i dy e më shumë viteve të kaluara në ndërmarrjet publike.

Për kërkesën dy, një mungesë të një politike të administrimit me tokën, urbane bujqësore një mungesë e infrastrukturës juridike sot kudo në Kosovë është duke u rezikuar prona. Prona komunale, prona shoqërore, prona e shtu quajtur shtetërore dhe pronat e koperativave bujqësore. Në komunën e Prishtinës brenda tre muajve të fundit janë zhdikur 42 hektarë tokë pronë e komunës, gjendja nuk është ma e mirë edhe në komunat

tjera, kjo praktikë e shemtuar duhet të ndërpritet me një urdhëresë ligjore, është domosdoshmëri ndërprerja e egër dhe e pakontrolluar të tokës pa një bazë të re ligjore, dhe arsyetimi për kërkesën tre.

RTK-ja është ndërmarrje publike, informative që financohet nga Qeveria përkatësisht nga BKK-ja kjo nuk është ndërmarrje e pavarur private, pavarësinë e ka vetëm në sferën e informimit por jo edhe në sferat tjera. Në kohën e fundit është shndërruar në piramidë informative dhe edukative që i porositë të gjithë gjeneratat, uluni para ekranit televeziv shikoni bingot, këndoni e kërceni, gjysëm lakoriqonu nëse doni të fitoni pa ndjersë e mot, asgjë nuk na duhet përveç siç na porosit ky televizion, porosi tjetër nuk shof në emisionet e RTK-së. Dy komisionet e para mund të janë të përkohëshme, mendoj se komisioni i medijave mund të jetë i përhershëm. Ju falemdnerit,

## **NEXHAT DACI**

Kur janë formuar komisionet e para kam obligim para Kuvendit kryesia është debatuar është aprovuar se kemi thanë se kemi nevojë një komision të përhershëm për mediat që pikërisht ka qenë përbajtja kjo, nuk është fajtor askush. Ne jemi marrë vesh që të punojmë me koncenzus, e kemi parë që nuk kemi koncenzus dhe më vjenë mirë që janë pjekë kushtet, nuk është vetëm kjo, është shkatrimi i Rilindjes, është shkatrimi i traditës së Kosovës, është shkatrimi i Televizionit të Prishtinës, është tradita e Kosovës, prandaj më vjenë mirë ma tepër për komisionet për çështjet që e brengos ministrin do të ishte nxjerra e ligjeve në të cilët prona e Kosovës me ligj garantohet dhe është pronë e Kosovës, unë do ti përkrahë kur është kjo nismë, fjalën e ka z. Kelmendi.

## **NEKIBE KELMENDI LDK**

Të nderuar deputetë,

Unë diskutimin tim do ta përqëndrojë vetëm në pikën e rendit të ditës apo çështjen që u diskutua sot lidhur me vendimin apo veton e z., Paskal Fieski lidhur me pjesëmarrjen e një partie që është regjistruar në serbi. Nëse neve subjekteve politike Kosovare na urdhërojnë që ti mbajmë kuvendet këtu në Kosovë apo kongreset e partisë në mënyrë që ti përbahemi rregullores, e cila i parashev kriteret e zgjdhedhjeve, atëhere nuk di dhe

nuk di të spjegojë ndryshe, a jemi në Kosovë a jemi në Serbi dhe ky Kuvend le të merr qëndrim lidhur me ate; jemi Kosovë apo jemi Serbi. Nese jemi Kosovë duhet të vlejnë rregullat e UNMIK-ut Rezoluta 1244 dhe ligjet që i nxjerrë ky parlament, nëse jemi Serbi ta di qartë. Përdryshe qendrimi i zotit Fieski që të merrë pjesë në zgjedhjet lokale edhe një parti që është regjistruar në Serbi është për ne shumë shqetësuese. Besoj se do ta sjellë në pikëpyetje edhe pjesëmarrjen ose daljen në zgjedhje disa subjekte politike Kosovare. Ju falemnderit.

### **BERAT LUZHA**

Jam zakonisht i zhgënjer me punën e Kuvendit deri sot dhe jam i zhgënjer, gjithashtu, edhe me punën e Kuvendit sot. Askund në botë nuk kam ndëgjuar se votohet për procedurë të mëtejshme. Kjo tendencë për t'i futur parlamentet deputetët në diskutime pa vendosur asgjë mendoj që është shumë e dëmshme pa e pregetur këtë mbledhje. Mbledhjet duhet të pregeten dhe të vihet me qëndrim të qartë. Në mbledhje duhet të diskutohet drejtëpërdrejtë për ligjet dhe në fund të miratohen dhe jo të bëhet lexim i parë, lexim i dytë, lexim të parë bëjënë vetëm komitetet, komisionet, në punën e parlamentit nuk ka lexime,

Unë propozoj dhe kërkojë nga Kryesia se tash e tutje të mos vonohemi sepse 7-8 muaj që janë ba zgjedhjet, ende nuk kemi asnjë ligj të miratuar. Ju falemderit.

### **SABIT RRUSTEMI**

E para, a frohet d'ata e dy korrikut, d'ita e miratimit të d'ekadës kushtetuese d'he pyes kryesinë e Kuvendit a ka parapa me një seancë solemne me rastin e 12 vjetorit të aprovimit të kësaj deklarate. E dyta në procesverbal, i cili është dalë nga seanca e kaluar une i kam pa dy emëra të rinjë i pyes deputetët se a e dinë se kur janë ba anëtarë të Kuvendit është fjala për Ali Ahmetin dhe është fjala për Sadik Rustemin, është migja im por nuk është deputet i Kuvendit.

### **HYDAJET HYSENI**

Të nderuar deputet, të nderuar anëtarë të Kryesisë,

Unë prita që çështjen që do ta shtroj sot do ta shtron dikush tjetër. Ne sot vendosëm edhe formimin e komisionit për barazinë gjinore. Kurse pikërisht këto ditë jemi ballafaquar me një interpretim shumë të pazakonshëm të regullës që është përkrahur gjithandej përfaqësimin e femres në institucionet e Kosovës. Interpretimi i ri edhe në praktikën e këtij Kuvendit e përcakton 33% të famshëm tani jo si kufi të poshtëm të përfaqësimit të femrës por në mënyrë paradoksale dhe vështirë absurde do të thosha edhe si kufi të epërm të këtij. Sipas kësaj logjike 66% është limiti i fundi i poshtëm i përfaqësimit të gjinisë tjetër. Kërkojmë që të gjithë ata që kanë ndikim së pari përfaqësuesit special i sekretarit të përgjithshëm të bëjë interpretimin adekuat të kësaj rregullative dhe përfaqësuesit e OSBG-së dhe të tjerët të evitojnë anomalinë që ta mundësojnë anëtaren Safete Hadergjonaj që nuk është e vetmja që të zë vendin e merituar në bankat e parlamentit sipas listës vetëm që është femër, dhe me këtë të evitojmë diskreditimin që e kemi konsideruar më të drejtë si një zgjidhje që e ndëron këtë Kuvend.

### **ZOTI PREKOPUCA**

Z. Kryetar, kryesi e Kuvendit,

Unë dola që ti shtrojë tri pyetje këtu. Flitet se është dhanë urdhëra për manifestimit gjegjësisht, çlirimin e Kosovës, 12 qershor, nuk e di a e din Parlamenti se në Fushë Kosovë ka ende që nuk është çliruar, posta, ndërtesa e Fushë Kosovës, funksionin se është uzurpu nga pala serbe. Shtëpia e shëndetit në Fushë Kosovë qe tri vite funksionon me njerëz të vdekur aty, marin lista për njerëz të vdekur. Ndërmarrja e tekstit JUMKO vin me autobusa nuk e di prej kahit e cila është e uzurpueme. Pyes kryesinë e Parlamentit që në mbledhjen e ardhëshme të na jap një informatë pse lejon UNMIK-u këte pse lejon KFOR-i ,pse lejon kjo Kryesi, pse lejon ky Parlament.

### **ALUSH GASHI**

Inderuari kryetar të ndëruar deputetë,

Pa qëllim të ligjerimit për rolin e jashtëzakonshëm për çdo shoqëri që kanë institucionet shëndetësore jam shumë i befasuar se ministria e shëndetësisë, respektivisht qeveria nuk e ka parapar miratimin e ligjit për shëndetësi, derisa fuqimisht mbështes aktivitetin e ministrisë së arsimit. Mendoj se është plotësisht e pa pranueshme se kjo ministri mos të

ketë dinamikën afat shkurtë ose ma së larti afatmesme të miratimit të ligjit. Një çështje tjetër, përshëndes pjesëmarjen e përfaqësuesve të qeverisë dhe ministrave dhe mendoj se zoti kryetar i Kuvendit, përfaqësues i qeverisë duhet të jetë vazhdimisht në seancat tonë përsëri porosin ta merr në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Ne e dim se këta tre muaj kanë qenë shumë të shkurtë me kërkua llogari nga ministria e shëndetësisë që është plotësisht e papranueshme që ministria e shëndetësisë së paku të del me një dinamikë të miratimit të ligjit. Ju falemnderit.

### **NEXHAT DACI**

E përfunduem mbledhjen, urdhëroni,

(NUK E DI EMRIN E DEPUTETIT)

I nderuar kryetar të ndëruarë deputetë,

Kam shtruar çështjen edhe në grupin parlamentar të LDK-së dhe mendoj se bartse e zhvillimit ekonomik të Kosovës do të jetë pasuri e cila i ka Kosova ato janë pasuritë minerale dhe energetike, kështu që mendimi im është të merret parasysh kërkesa që në kuadër të Kuvendit të Kosovës të funksionin edhe komisioni për burimet minerale dhe energetike. Ju falemnderit.

### **NEXHAT DACI**

Parlamenti i Kosovës i ka 120 deputetë, me dy komisione që sot i formuam janë 18 gjithësej me 11 anëtarë. Në qoftëse në një komision një deputet duhet të jetë në 5 komisione, ato 5 ditët e javës do të jetë vetëm nëpër komisione nuk është e arsyeshme unë do të falenderoja për pjesëmarrje është shumë ma aktive të gjithë deputetëve edhe ata që kishin mendime tjeterfare për ate të Kryesisë, do të kërkojë falje, Ju falemnderit.

U mbarua traka.